



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:003031

Datë: 06.03.2024

Numri i dokumentit: 05419206

C.nr.72/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Baki Shigjeqi dhe bashkëpunëtoren profesionale H.D. në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.U. me numër personal nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson N.K. avokat nga Prizreni, kundër të paditurës Stacioni i Autobusëve, me seli në Prizren, të cilën e përfaqëson, F.Ç. nga Prizreni, e të cilin me autorizim e përfaqëson, L.B. avokat nga Prizreni, me objekt të padisë kompensimi i shpërblimit jubilarë, vlera e kontestit 966.00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor-publik, në prani të paditësit dhe të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, me datë 05.03.2024, mori, ndërsa me datë 06.03.2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Refuzohet në tërësi** kërkesëpadia e paditësit N.U. nga Prizreni, me të cilën kanë kërkuar që të *“Aprovohet kërkesëpadia e parashtruesit N.U. nga Prizreni. OBLIGOHET Njësia punuese Stacioni i Autobusëve në Prizren, që të më njoh të drejtën e pagesës dhe atë në emër të shpërblimit jubilar në tri rroga - shumë prej 966 euro, me kamatë ligjore prej 8%, nga data 01.09.2019, gjer në pagesën përfundimtare të kësaj shume të kërkuar e të gjitha këto brenda 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm” si e pa bazuar.*
- II. DETYROHET** paditësi që t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore të paditurës, në shumë prej 711.50 € (shtatëqind e njëmbëdhjetë euro e pesëdhjetë cent), në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

1. Historiku i çështjes dhe Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi N.U. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij N.K. avokat nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Stacioni i Autobusëve, me seli në Prizren, me objekt të padisë kompensimin e shpërblimit jubilarë dhe pagave përcjellëse.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore ka marrë aktgjykimin me shenjën C.nr.4/2020, të datës 08.10.2021, duke e refuzuar në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, si dhe e ka obliguar që t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore të paditurës, si në këtë aktgjykim. Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjore ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit N.U. avokat N.K. nga Prizreni.

Gjykata e Apelit e Kosovës në Prishtinë, me aktgjykimin me shenjën Ac.nr.143/2022, të datës 20.12.2023, e ka prishur aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren që ka të bëj me të drejtën për shpërblimin jubilar dhe sa i përket shpenzimeve të procedurës, dhe për këtë pjesë çështja është kthyer në rivendosje gjykatës së shkallës së parë, ndërsa sa i përket pjesës lidhur me pagat përcjellëse, ankesa e paditësit është refuzuar si e pabazuar dhe aktgjykimin i Gjykatës Themelore në Prizren me shenjën C.nr.4/2020, i datës 08.10.2021, në këtë pjesë është vërtetuar.

Duke vepruar sipas Aktgjykimit me shenjën Ac.nr.143/2022, të datës 20.12.2023, të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, Gjykata Themelore në Prizren ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin kryesor, në të cilin janë marrë parasysh dhe është vepruar sipas vërejtjeve të dhëna sipas aktgjykimit të lartcekur.

Edhe gjatë shqyrtimit të mbajtur pas kthimit të çështjes në rigjykim, i autorizuari i paditësit ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë padisë dhe kërkesë padisë, duke theksuar se tani pala paditëse me padi kërkon kompensimin e tri pagave jubilarë. Në fjalën përfundimtare ka deklaruar se me administrimin e provave nga shkresat e lëndës, dhe aplikimin e dispozitave ligjore nga marrëveshje e përgjithshme kolektive, dhe në kuptim të ligjit të punës, është arsyetuar arsyeshmëria e kësaj kërkesë padie, tani e precizuar në kërkesën për kompensimin e tri pagave jubilarë, ngase paditësi para pensionimit të tij ka qenë në marrëdhënie pune te pala e paditur, dhe kërkojnë që në emër të tri pagave ti kompensohet shuma 966.00 euro me kamatë ligjore prej 8% nga data e parashtrimit të padisë 01.09.2019. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar në shumën e përgjithshme prej 770.00 euro, bazuar në tarifën e OAK.

Edhe gjatë shqyrtimit të mbajtur pas kthimit të çështjes në rigjykim, i autorizuari i të paditurës ka deklaruar se qëndron në tërësi pranë përgjigjes në padi, ndërsa në fjalën përfundimtare ka theksuar se në bazë të provave të administruara, e që janë të gjitha të propozuara nga pala paditëse, është vërtetuar se viti jubilar për 30 vite përvojë pune të pa ndërprerë të paditësit është arritur në kohën kur nuk ka qenë fare e lidhur marrëveshje e përgjithshme kolektive. Andaj nga këto arsye ka propozuar refuzimin e kërkesë padisë. Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar dhe atë 104 euro për përgjigje në padi, dhe për 5 seanca gjyqësore nga 135.00 euro, e që në total rezulton me shumën 779.00 euro.

2. Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: leximi i procesverbalit të datës 10.09.2021, në të cilat është bërë administrimi i këtyre provave: shikimi në kopjen e librezës së punës së paditësit me numër serik 74819, me numër të regjistrimit 12419, dhe atë dy faqe të kësaj libeze; shikimi në kopjen e kontratës së punës të datës 18.06.2018, me numër të rprotokollit 194, të cilën e kanë lidhur në kohë të pacaktuar palët ndërgjyqjësë; shikimi në vendimin e datës 19.09.2019, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamentit të pensioneve; shikimi në gjendjen e llogarisë bankare të paditësit të lëshuar me datë 27.08.2021, nga BKT – njësia në Prizren. Gjkata ka bërë leximin e procesverbalit të datës 23.09.2021, në të cilën është bërë dëgjimi i dëshmitarit F.Q. nga Prizreni, Drejtor i Njesisë Punuese të Stacionit të Autobusëve në Prizren.

Gjkata pas vlerësimit të theksimeve të palëve dhe provave të administruara në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit **është e pa bazuar**.

Nga shikimi në kopjen e librezës së punës së paditësit me numër serik 74819, me numër të regjistrimit 12419, dhe atë dy faqe të kësaj libeze, vërtetohet fakti se paditësit ka filluar punën tek e paditura me datë 02.08.1977 dhe e ka ndërprerë për shkak të pensionimit me datë 27.08.2019

Nga shikimi në kopjen e kontratës së punës të datës 18.06.2018, me numër të protokollit 194, të cilën e kanë lidhur në kohë të pacaktuar palët ndërgjyqjësë, vërtetohet fakti se e paditura si punëdhënës dhe paditësi si punëmarrës kanë lidhur kontratë të punës në kohë të pa caktuar duke filluar nga data 18.06.2018, për vendin e punës Laurist, në Njësinë Punuese Stacionin e Autobusëve.

Nga shikimi në vendimin e datës 19.09.2019, të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamentit të pensioneve, vërtetohet fakti se paditësit i njihet e drejta në kategorizim për pension kontribut pagues të moshës me rastin e pensionimit.

Nga shikimi në gjendjen e llogarisë bankare të paditësit të lëshuar me datë 27.08.2021, nga BKT – njësia në Prizren, vërtetohet fakti se paditësi për tre muajt e fundit, ka marrë pagën nga e paditura në shumën prej 322.50 euro.

Gjkata ka bërë dëgjimin e dëshmitarit Fidan Qengaj nga Prizreni, Drejtor i Njesisë Punuese të Stacionit të Autobusëve në Prizren, nga dëshmia e të cilit kjo gjykatë ka provuar se sipas së cilit deri më tani nuk ka pasur asnjë rast të punësuarve tjerë të cilët janë pensionuar e ata nuk kanë bërë kërkesë për të marrë pagë jubilarë dhe pensionimit e më tutje ka sqaruar se nuk kanë pranuar asnjëherë kërkesë nga paditësi për kompensimin e pagës jubilarë dhe pagave përcjellëse.

3. Baza ligjore

Sipas nenit 4 par. 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (LP), në mënyrë decisive përcaktohet se “Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj”. Po ashtu, në nenin 90 par. 5 të LP-së, theksohet që “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”. Pastaj, në bazë të nenit 78 të LP-së, parashihet e drejta e të punësuarit që të kërkoj nga punëdhënësi për realizim të ndonjë të drejte dhe punëdhënësi është i obliguar që të vendos lidhur me një kërkesë të tillë. Në vazhdim, me nenin 79 të Ligjit të Punës, përcaktohet e drejta e të punësuarit që të kërkoj mbrojtje gjyqësore në Gjykatë Kompetente lidhur me vendimin apo mos veprimin e punëdhënësit lidhur me ndonjë kërkesë së të punësuarit.

Po ashtu në nenin 52 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, të lidhur me datë 18.03.2014, e cila ka hyrë në fuqi nga data 01.01.2015, e nënshkruar nga Organizatat e Punëdhënësve (Oda Ekonomike e Kosovës dhe Aleanca Kosovare e Biznesit), Organizatat e të Punësuarve (Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës) si dhe Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale), parashihet se: “I punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të një paga mujore të tij; për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, te punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij” derisa paragrafi 2 i këtij neni parasheh se: “Punëdhënësi i fundit është ai që paguan shpërblime jubilarë” dhe se paragrafi 3 i këtij neni parasheh se: “Shpërblimi jubilar, paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf”.

4. Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Duke marrë parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjyqëse, provat e administruara më lartë në lidhje me këtë çështje kontestimore dhe dispozitat e lartcekura ligjore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar dhe se e njëjta duhet të refuzohet, sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga provat e administruara, për gjykatën dhe palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune pranë të paditurës në vendin e punës Laurist, në Njësinë Punuese të Stacionit të Autobusëve, me seli në Prizren, deri me datë 27.08.2019, kur të njëjtit iu është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të pensionimit. Kontestuese mbetet fakti nëse paditësit i takon kompensimi në lartësi prej 966.00 euro, në emër të shpërblimit jubilar për 30 vite të përvojës së punës.

Referuar pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, e në lidhshmëri me provat të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje, rrjedh se paditësi marrëdhënien e punës tek e paditura e ka themeluar me datë 02.08.1977, marrëdhënie kjo e cila ka vazhduar deri me datën 28.07.2019, kur është pensionuar paditësi. Një fakt i tillë vërtetohet nga librezja e punës me numër të serisë 74819 dhe numër të regjistrimit 12419, nga e cila është konstatuar se paditësi ka përvojë pune rreth 42 vite. Bazuar në një përlllogaritje të tillë, rrjedh se paditësi 30 vite të

përvojës së punës i ka përmbushur me datë 02.08.2007, që paraqet edhe moment kur të njëjtit i ka lindur e drejta për të kërkuar shpërblimin jubilar për 30 vite të përvojës së punës.

Në anën tjetër, Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, që shërben si akt mbi bazën e të cilit paditësi e mbështetë kërkesëpadinë, gjegjësisht të drejtën për kompensimin e shpërblimit

jubilar, është nënshkruar nga Organizatat e Punëdhësve, Organizata e të Punësuarve si dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, me datë 18.03.2014, ndërsa ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 (konform nenit 82 të kësaj Marrëveshje). Si rrjedhojë, Gjykata arrin në përfundim se paditësi vitin jubilar për 30 vite të përvojës së punës, e ka arritur gjatë një periudhe kohore kur Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, nuk ka qenë në fuqi.

Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, beneficonet e përcaktuara me nenin 52 të Marrëveshjes së lartcekur, paditësit do t'i takonin me kusht që i njëjti vitin jubilar për 30 vite të përvojës së punës ta ketë arritur gjerë sa kjo Marrëveshje ka qenë në fuqi, gjegjësisht ndërmjet periudhës kohore nga data 01.01.2015, e gjer me datën 31.12.2017.

Gjykata me rastin e vlerësimit dhe vendosjes së kësaj çështje iu referua edhe Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës GJ.A.Su.A.nr.40/2023, të datës 27.02.2023. Në pjesën e dytë, pikën VI, të këtij Mendimi, ku flitet për kushtet për fitimin e të drejtës së shpërblimit jubilar, përcaktohet se për tu fituar e drejta në shpërblim jubilar duhet të plotësohen dy kushte në mënyrë kumulative, fillimisht: a) *që viti jubilar i punësimit për 10, 20, dhe 30 vjet të përvojës së punës të arrihet në kohën kur kjo marrëveshje aplikohet gjegjësisht në mes periudhës kohore nga data 01.01.2015 e gjer me datën 31.12.2017, si dhe b) përvoja e punës për 10, 20 dhe 30 vite, duhet të jetë e pandërprerë te punëdhënësi i fundit*. Referuar Mendimit Juridik të lartcekur, Gjykata vlerëson se ekziston vetëm një moment përcaktues i arritjes së kushtit për të përfituar të drejtën e shpërblimit jubilar, e që ka të bëjë me përmbushjen e vitit jubilar për 10, 20 apo 30 viteve të përvojës së punës gjatë kohës kur aplikohet Marrëveshja në fjalë. Në rastin konkret, momenti i fitimit të kësaj të drejte për paditësin është arritur në muajin gusht të vitit 2007, kur i njëjti ka përmbushur 30 vite të përvojës së punës së pandërprerë tek e paditura, periudhë kjo gjatë së cilës nuk ka qenë në fuqi Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës.

Si përfundim, Gjykata vlerëson se paditësit i mungon baza ligjore e mbështetjes së kërkesëpadisë, andaj vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që në emër të tri pagave për shpërblim jubilar t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej 966.00 euro, së bashku me normën e kamatës në lartësi prej 8%, e cila do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive.

Në kuptim të dispozitave të nenit 420 par.3 të LPK-së, gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor, menjëherë pas mbajtjes së seancës përgatitore, pas propozimit të vet palëve ndërgjyqëse.

Vendimin që pala paditëse ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 463.1 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të përgjigjes në padi në shumën prej 104.00 euro, për përfaqësim në katër seanca gjyqësore në shumën prej 540.00 euro (4x135), për një seancë të shtyrë shumën prej 67.50 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme 711.50 euro (shtatëqind e njëmbëdhjetë euro e pesëdhjetë cent).

Gjykata gjeti si pjesërisht të bazuar kërkesën e paditësit që lidhur lidhur me kompensimin e shpenzimeve gjyqësore për seancën e datës 05.02.2024, ti kompensohet shuma prej 135.00 €, pasi që kjo seancë nuk është mbajtur, e njëjta është shtyrë me kërkesë të të autorizuarit të paditësit, andaj kjo kërkesë duhet të aprovohet pjesërisht.

Andaj, gjykata bazuar në arsyet dhe faktet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2020:003031, 06.03.2024

G j y q t a r i,

Baki Shigjeqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe Gjykatën.